



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LIBOHOVË
NJËSIA E PROKURIMIT

Nr. _____ Prot

Libohovë , më ____ .08.2026

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje autobetoniere për nevojat e Bashkisë”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Automjetet me katër rrota 34113000-2

Automjete për të gjitha terrenet 34113200-4

VLERA E FONDIT LIMIT /vlera e pritshme e kontratës:

2,800,000 (dy milionë e tetëqind mijë) lekë pa TVSH

Në bazë të nenit 21, pika 2, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c, nenit 78, pika 2 dhe nenit 74, pika 4 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe Urdhrit nr.125 datë 04.08.2026 të Kryetarit të Bashkisë “Për caktimin e personave përgjegjës për hartimin e specifikimeve teknike”, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Libohovë** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*

Argumentimi: Ky kriter u vendos bazuar në nenin 76 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik“, i ndryshuar dhe nenin 26 të VKM-së nr. 285, date 19.05.2021 ”Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik” i ndryshuar, në të cilën është përcaktuar se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

Argumentimi: Ky kriter u vendos sipas nenit 83 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, në të cilin është parashikuar se: Neni 83, pika 1: “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël. Neni 83, pika 2 : Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit: a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përlllogaritur të kontratës; b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës, si dhe në nenin 30 të VKM-së nr 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

Ofertuesi duhet të paraqesë:

1.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme): Kjo pikë plotësohet me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1.1.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin **vërtetim** për xhiron vjetore për vitet financiare **2023-2024-2025**, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 30%** e vlerës së fondit limit të kontratës. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Shënim: “Vlera e kërkuar jo më e vogël se vlera e fondit limit është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 41 pika 2 ku përcaktohet se: “Kërkesa të veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohej, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme mbështetet në Nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar si dhe në Kreun V, Seksioni III, Nenin 40, 43, pika 2 dhe pika 3 e VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Kërkesat e renditura sipas Kapacitetit ekonomik dhe financiar i shërbejnë Autoritetit Kontraktor, për të provuar nëse Ofertuesit zotërojnë kapacitet financiar për të përmbushur me sukses kontratën objekt prokurimi. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji”.

1.1.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë **kopje të bilanceve**, të certifikuara nga autoritetet përkatëse (Dega e Tatim Taksave) për vitet **2023, 2024 dhe 2025 ku të paktën në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.**

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP-së, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, nenit 41, të ligjit Nr. 10 091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare”, përcaktohen rastet kur personat juridikë kanë detyrimin që të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese. (Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen rastet kur personat juridikë kanë detyrimin që të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese).

Kapaciteti teknik:

1.1.3 Për të provuar **përvojën e mëparshme**, për kontratat e mallrave, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë **jo më të vogël se 20%** të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

- Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasinë e mallrave të furnizuara.

- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasinë e mallrave të furnizuara

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Përcaktimi i vlerës për kontratat e ngjashme është përcaktuar referuar bazës ligjore sa më sipërcituar dhe vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet. Referuar sa më sipër dhe me qëllim njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë, përvojën e duhur në funksion të realizimit me sukses të kontratës autoriteti kontraktor ka përcaktuar vlerën për kontratat e ngjashme. Përvoja e mëparshme është një element shumë i domosdoshëm që garanton autoritetin kontraktor se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së kontratave të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në nenin 55 “Procedurë e hapur e thjeshtuar” pika 4/b të vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: 4. Në këtë lloj procedure prokurimi, autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në konsideratë të përcaktojnë kritere të thjeshtuara pranimit, me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së biznesit të vogël dhe të mesëm. Lidhur me kërkesat për përvojën e ngjashme, vlera e kërkuar në procedurat e thjeshtuara duhet të jetë: b) Për kontratat e mallrave dhe shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Njësia përcaktoj kriteret për furnizime të ngjashme

si më lart duke qënë se këto kritere janë të detyrueshme, janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës. Sipas këtij neni, Njësia vlerëson se duhen kërkuar dokumentacioni ligjor sipas parashikimit të pikës 4/b të nenit 55 që provon kryerjen e furnizimeve të ngjashme.

1.1.4 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë **vetëdeklarim** nëpërmjet të cilit merr përsipër të garantojë mjetin objekt të prokurimit për një periudhë **prej 6 (gjashtë) muajsh nga data e marrjes në dorëzim**, për defektet dhe problematikat teknike që lidhen me gjendjen dhe funksionimin normal të mjetit. Operatori ekonomik fitues merr përsipër të kryejë, me shpenzimet e veta, riparimin ose zëvendësimin e pjesëve me defekt që mbulohen nga garancia.

Argumentim: Në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenit 40, pika 8 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të vendosë kritere kualifikimi që lidhen drejtpërdrejt me objektin e kontratës dhe që synojnë garantimin e cilësisë dhe funksionalitetit të mallrave që do të prokurohen. Kërkesa për paraqitjen e një vetëdeklarimi lidhur me garantimin e eliminimit pa shpërblim të defekteve çdo problemi teknik të mundshëm për një periudhë 6 (gjashtë) mujore nga data e dorëzimit të mjetit, konsiderohet e arsyeshme dhe proporcionale, pasi synon mbrojtjen e interesit publik dhe sigurimin e përdorimit normal dhe të sigurt të mjetit gjatë periudhës së shfrytëzimit nga Autoriteti Kontraktor. Përgjigje të rastëve kur defekti vërtetohet se është shkaktuar nga pakujdesia e shoferit ose keqpërdorimi i mjetit është në përputhje me parimin e proporcionalitetit dhe shmang ngarkimin e padrejtë të operatorit ekonomik me përgjegjësi që nuk lidhen me cilësinë e mallit të ofruar.

1.1.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë **vetëdeklarim** se, në rast shpalljeje fitues, merr përsipër të përballojë të gjitha shpenzimet dhe detyrimet administrative që lidhen **me kalimin dhe regjistrimin e pronësisë së mjetit** objekt të kontratës në emër të Bashkisë Libohovë, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Argumentim: Bazuar në nenin 77 të Ligjit nr. 162/2020, i ndryshuar nenit 40, pika 8 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, kriteret e kualifikimit duhet të jenë të lidhura me realizimin e kontratës dhe të sigurojnë përmbushjen e plotë të detyrimeve kontraktuale nga operatori ekonomik. Kërkesa që operatori ekonomik, në rast se shpallet fitues, të mbulojë të gjitha shpenzimet për kalimin e pronësisë së mjetit në emër të Bashkisë Libohovë, lidhet drejtpërdrejt me përfundimin ligjor dhe faktik të objektit të kontratës. Pa kryerjen e këtij veprimi, Autoriteti Kontraktor nuk mund të konsiderohet pronar i ligjshëm i mjetit dhe kontrata nuk realizohet plotësisht. Ky kriter nuk krijon diskriminim dhe zbatohet në mënyrë të barabartë për të gjithë operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duke garantuar transparencë dhe siguri juridike për Autoritetin Kontraktor.

1.1.6 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë **fotografi të qarta të mjetit** të ofruar, duke mundësuar identifikimin e plotë të tij dhe vlerësimin paraprak të gjendjes së jashtme të mjetit. Fotografitë duhet të paraqesin në mënyrë të qartë mjetin e ofruar dhe të jenë në përputhje me të dhënat e deklaruara nga operatori ekonomik

Argumentim: Në përputhje me nenin dhe nenin 77 të Ligjit nr. 162/2020, i ndryshuar, nenit 40, pika 6/b (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kërkojë informacion dhe dokumentacion që shërben për verifikimin e përputhshmërisë së ofertës me specifikimet teknike. Kërkesa për paraqitjen e fotografive të qarta dhe origjinale të mjetit nga të gjitha anët synon verifikimin paraprak vizual të gjendjes fizike, integritetit dhe përputhjes së mjetit me përshkrimin teknik të kërkuar në dokumentet e tenderit. Ky kriter nuk është kufizues, nuk kërkon investime shtesë nga operatorët ekonomikë dhe shërben si mjet mbështetës për vlerësimin objektiv dhe transparent të ofertave.

1.1.7 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë se disponon mjetin konkret të ofruar për realizimin e objektit të kontratës, si dhe të deklarojë vendndodhjen e saktë të tij dhe të dhënat identifikuese të mjetit.”

1.1.8 Autoriteti Kontraktor, në funksion të verifikimit të përmbushjes së kërkesave të përcaktuara në DST, ka të drejtë, **kur e çmon të nevojshme** të kryej verifikimin fizik të mjetit të deklaruar nga operatori, përpara marrjes së vendimit përfundimtar për shpalljen e fituesit, me qëllim verifikimin e disponueshmërisë dhe përputhshmërisë së tij me specifikimet teknike të përcaktuara në Dokumentet e Tenderit

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikës 8 të nenit 40, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të përcaktojë kërkesa për kapacitetin teknik dhe profesional të operatorëve ekonomikë, për aq sa këto kërkesa janë të lidhura dhe proporcionale me objektin e kontratës dhe janë të nevojshme për të garantuar aftësinë reale të operatorit ekonomik për realizimin e saj. Në këtë kuadër, kërkesa që operatori ekonomik të deklarojë mjetin konkret që do të përdorë për realizimin e objektit të kontratës, së bashku me vendndodhjen dhe të dhënat identifikuese të tij, është e lidhur drejtpërdrejt me nevojën e Autoritetit Kontraktor për të verifikuar paraprakisht ekzistencën dhe disponueshmërinë reale të kapacitetit teknik të deklaruar nga operatori ekonomik. Përcaktimi i mjetit konkret, dhe jo vetëm deklarimi në mënyrë të përgjithshme i disponimit të mjeteve, i mundëson Autoritetit Kontraktor të identifikojë kapacitetin teknik që operatori ekonomik angazhohet të vërë në dispozicion për realizimin e kontratës dhe të vlerësojë përputhshmërinë e tij me kërkesat dhe specifikimet teknike të përcaktuara në Dokumentet e Tenderit. Parashikimi i së drejtës së Autoritetit Kontraktor për të kryer, kur e çmon të nevojshme, verifikim fizik të mjetit konkret të deklaruar është një masë kontrolli dhe verifikimi që synon të garantojë vërtetësinë, saktësinë dhe besueshmërinë e informacionit të paraqitur në ofertë, si dhe të sigurojë që kapaciteti teknik i deklaruar nga operatori ekonomik përputhet me gjendjen faktike të tij. Theksohet se verifikimi fizik nuk përbën një detyrim automatik të Autoritetit Kontraktor dhe nuk do të kryhet domosdoshmërisht ndaj çdo operatori ekonomik, por përbën një të drejtë të Autoritetit Kontraktor, e cila mund të ushtrohet në mënyrë objektive dhe të arsyeshme, kur kjo vlerësohet e nevojshme për verifikimin e përmbushjes së kërkesave të përcaktuara në Dokumentet e Tenderit. Kriteri dhe mekanizmi i verifikimit janë në përputhje me parimet e trajtimit të barabartë, mosdiskriminimit, transparencës, proporcionalitetit dhe nxitjes së konkurrencës, pasi kërkesa lidhet drejtpërdrejt me kapacitetin teknik të nevojshëm për realizimin e objektit të kontratës dhe nuk vendos kërkesa që tejkalojnë atë që është e nevojshme për arritjen e qëllimit të prokurimit. Për rrjedhojë, kërkesa për deklarimin e mjetit konkret dhe rezervimi i së drejtës së Autoritetit Kontraktor për verifikimin fizik të tij përbëjnë një masë të arsyeshme dhe proporcionale për uljen e riskut të deklarimeve të pasakta, garantimin e kapaciteteve reale të operatorit ekonomik dhe mbrojtjen e interesit publik, duke siguruar që kontrata të realizohet nga një operator ekonomik që disponon faktikisht mjetet dhe kapacitetet teknike të kërkuara.

NJËSIA E PROKURIMIT

Kristaq Ciko

Xhelil Tusuni

Niko Këreci